



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr.3 Prot.

Tepelenë, më 26.02.2026

**PROÇES – VERBAL**

**(I zbardhur nga origjinali)**

I mbajtur sot, më datë 26.02.2026, ora 11:00 në Pallatin e Kultures (kati II dytë) në mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak Tepelenë me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Për miratimin e procesverbalit të mbledhjeve të kaluara datë 29.01.2026, 13.02.2026.
3. **Projektvendim:** “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fond 6% të fondit të kushtëzuar për muajin Janar 2026.”
4. **Projektvendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin Janar 2026.”
5. **Projektvendim:** “Për miratimin e raportit vjetor të zbatimit të buxhetit për vitin 2025.”
6. **Projektvendim:** “Për detajimin e plan–buxhetit për fondet nga transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale, granti të bazuar në performancë me burim financimi buxheti i shtetit dhe të ardhurat e veta të trashëguara nga viti 2025.”
7. **Projektvendim:** “Për përcaktimin e destinacionit/qëllimit të përdorimit të fondit nga granti i bazuar në performancë për vitin 2025, me burim financimi të huaj.”
8. Raporti i performancës së Këshillit Bashkiak Tepelenë për vitin 2025.
9. Çështje të tjera.
10. Trajtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes 11:00

Kryetar i Këshillit Bashkiak Z. Arben Gumeni drejton mbledhjen.

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes:

- Latif Kaçaj

- Mirela Varfi
- Mjaftoni Zeraj
- Matilda Çela
- Vladimir Bakiaj
- Esmeralda Bishani (ora 11.40)
- Ilir Haska
- Besnik Mece
- Vladimir Gjonca
- Ditar Hodaj
- Arben Gumeni
- Marsela Balili
- Besnik Maca

Marrin pjesë nga Administrata e Bashkisë:

- Spiro Kora
- Armand Sala
- Lumturi Dervishi
- Paula Demiri
- Festime Elezi
- Rovenë Mullaraj

**Kryetari i Këshillit, z. Arben Gumeni**, përshëndet të pranishmit dhe hap mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin shkurt, paraqet rendin e ditës për shqyrtim dhe miratim, jeni dakord me rendin e ditës ta hedhim në votim.

Kryetari i Këshillit deklaron hapjen e votimit për miratimin e rendit të ditës.

**Vota pro (12):** Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Besnik Maca.  
**Vota kundër** nuk ka.**vota abstenim** nuk ka.

**Pika e dytë e rendit të ditës:** Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të kaluara, datë 29.01.2026 dhe 13.02.2026

Kryetari i Këshillit; Ka pyetje në lidhje me procesverbalet e mbledhjeve të kaluara, jo, hedhim në votimit për miratimin e procesverbalit të mbledhjeve të kaluara.

**Vota pro (12):** Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Besnik Maca.  
**Vota kundër** nuk ka.**vota abstenim** nuk ka..

**Pika e tretë e rendit të ditës:** Projektvendim: “Për miratimin e ndihmës ekonomike me fondin 6% të fondit të kushtëzuar për muajin janar 2026”

Kryetari i Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e merr znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit të Ekonomisë, Komisioni është mbledhur dhe është njohur me materialin për dhënien e ndihmës ekonomike me fondin 6% për muajin janar 2026, do të trajtohen me ndihmë ekonomike 10 familje, ndërsa 1 familje është larguar nga skema pasi ka përfituar KEMP, propozoj miratimin e projektvendimit.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje. Nuk ka. Projektvendimi hidhet në votim;

**Vota pro (12):** Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Besnik Maca. **Vota kundër** nuk ka. **vota abstenim** nuk ka.

**Pika e katërt e rendit të ditës:** Projektvendim: “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin janar 2026”

Kryetari i Këshillit deklaroi shqyrtimin e projektvendimit.

Fjalën e merr znj. Matilda Çela, Kryetare e Komisionit të Ekonomisë, Për muajin janar do të trajtohen 94 familje nga fondi i Bashkisë, është shtuar 1 familje në Njësinë Administrative Lopës dhe 1 familje në Njësinë Administrative Kurvelesh, propozoj hedhjen në votim të projektvendimit.

Kryetari i Këshillit: Ka pyetje. Nuk ka. Projektvendimi hidhet në votim;

**Vota pro:** (12) Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Besnik Maca. **Vota kundër** nuk ka. **vota abstenim** nuk ka.

**Pika e pestë e rendit të ditës Projektvendim:** “Për miratimin e raportit vjetor të zbatimit të buxhetit për vitin 2025”.

Fjalën e merr z. Ditar Hodaj: Pse duhet të vijë për miratim në Këshillin Bashkiak ky dokument? Pse duhet ta miratojmë ne?

Fjalën e merr z. Spiro Kora; Drejtor i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar; Në bazë të ligjit nr. 139/2015 Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44, është përcaktuar detyrimi për paraqitjen e raportit vjetor financiar. Sipas këtij neni, Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport për veprimtarinë financiare në zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, duke përfshirë edhe institucionet në varësi të saj.

Raporti i paraqitet Këshillit jo më vonë se data 31 mars 2026.

Në raportin e bashkëngjitur për miratim, ne jemi përpjekur të paraqesim një panoramë të plotë të situatës financiare në të cilën ndodhet Bashkia, si dhe të gjitha hapat dhe veprimtaritë e ndjekura për arritjen e treguesve financiarë. Raporti është hartuar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi në zbatim;

- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligji nr. 9936/2008, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296/2010, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 51;
- Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 72, datë 27.11.2024 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2025”, i ndryshuar;

Ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim raporti për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2025, i cili mbështetet në tre shtylla kryesore:

- a) Raportin e Monitorimit të Buxhetit për vitin 2025;
- b) Pasqyrat Financiare të vitit 2025;
- c) Raportin mbi zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Treguesit kryesorë për vitin 2025, të ardhurat e veta janë realizuar në masën **89.6%** të planit vjetor të ndryshuar.

Shpenzimet e përgjithshme janë realizuar në masën **94.6%** mbi planin vjetor të ndryshuar.

Realizimi i të ardhurave sipas njësive administrative: Njësia Administrative Qytet – 93.4%, Njësia Administrative Qendër – 93%, Njësia Administrative Kurvelesh – 66%, Njësia Administrative Lopës – 57.3%. Nga njësitë administrative rezulton një mosrealizim i të ardhurave në shumën 8,660,000 lekë.

Mosrealizim ka njohur edhe taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja, e cila ishte planifikuar në vlerën **20,000,000 lekë**, ndërsa është realizuar në shumën **11,321,340 lekë**, me një diferencë prej **8,678,660 lekë** ose **56.6%** realizim.

Është krijuar dhe funksionon regjistri i taksës së tokës bujqësore, megjithatë konstatohet mangësi në njoftimin e disa taksapaguesve për shkak të lëvizjeve demografike.

Nga viti 2025 në vitin 2026 do të trashëgohen gjithsej 34,900,619 lekë, nga të cilat:

Nga transfertat: 31,870,586 lekë

Nga të ardhurat e veta: 3,030,033 lekë

Shpenzimet janë pasqyruar sipas tabelave perkatëse sipas programeve buxhetore për vitin 2025.

Pagat – 97.6%, Sigurimet shoqërore – 95.6%, Shërbimet operative – 96.7%, Transferta e klubit të futbollit – 74.7%, Transfertat për individët – 96.4%, Shpenzimet kapitale – 59.8%

Në strukturën e shpenzimeve të realizuara për vitin 2025, peshën kryesore e zënë:

- Pagat – 51.9%
- Sigurimet shoqërore – 8.2%
- Shpenzimet operative – 31.3%
- Transferta e klubit të futbollit – 1.8%
- Transfertat për individët – 2.3%
- Shpenzimet kapitale – 4.2%

Vend të rëndësishëm në buxhetin e vitit 2025 ka zënë likuidimi i detyrimeve të prapambetura për mallra dhe shërbime, në shumën 16,500,000 lekë, ose 14.8% të totalit të shpenzimeve gjatë vitit 2025.

Një vend të rëndësishëm ka zënë mbështetja sociale. Për buxhetet familjare janë shpenzuar gjithsej **7,957,556 lekë**, konkretisht:

1. Ndihmë ekonomike nga buxheti i pavarur – 4,436,000 lekë (rreth 80 familje përfituese çdo muaj);
2. Mbështetje financiare për familje dhe individë në nevojë – 3,089,536 lekë (rreth 50 familje përfituese);
3. Bonus qiraje – 432,020 lekë, si pjesë e bashkëfinancimit (rreth 40 familje përfituese çdo muaj).

Situata financiare e Bashkisë Tepelenë për vitin 2025 paraqitet normale. Disa nga çështjet kryesore që kërkojnë vëmendje në vijim janë: Një ndryshim rrënjësor në punën për mbledhjen e të ardhurave, si nga Sektori i Tatim-Taksave ashtu edhe nga agjentët e tjerë tatimorë, ku rol të rëndësishëm luajnë Drejtoria e Bujqësisë, Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit mbi Territorin, si dhe Policia Bashkiake. Planifikim më i saktë dhe zgjerim i bazës së tatimpaguesve, si në qytet ashtu edhe në njësitë administrative. Planifikim i saktë dhe i argumentuar i kërkesave për shpenzime nga njësitë shpenzuese. Punë më e kujdesshme dhe me përgjegjësi më të lartë nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, në drejtim të dokumentimit në kohë dhe kryerjes së pagesave vetëm kur ato të jenë të shoqëruara me dokumentacion të plotë justifikues dhe të jenë të programuara në buxhetet afatmesme dhe vjetore. Të vijojë përmirësimi i rregullores së brendshme të institucionit, duke përcaktuar qartë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit punonjës, si dhe duke vendosur mekanizma të qartë përgjegjshmërie mbi këtë bazë. Auditimi i performancës dhe funksionimi efektiv i sistemeve të kontrollit të brendshëm të mbeten një nga drejtimet kryesore të punës. Zbatimi i rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit të jetë një prioritet i vazhdueshëm institucional. Pjesë e raportit janë edhe Pasqyrat Financiare për vitin 2025, të cilat janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit, në përputhje me afatet dhe kërkesat ligjore në fuqi. Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ushtruar auditim në subjektin Bashkia Tepelenë, në bazë të programit të auditimit nr. 470/1 prot., datë 25.04.2025, për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2024 deri më 31.12.2024. Me vendimin nr. 185, datë 09.10.2025, të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar zbatimi i disa masave

organizative dhe administrative. Bashkia Tepelenë, me shkresën nr. 756/7, datë 21.10.2025, ka njoftuar se është njohur me Raportin Përfundimtar dhe me rekomandimet e auditimit financiar. Pjesë e raportit janë edhe Pasqyrat Financiare për vitin 2025, të cilat janë dorëzuar pranë Degës së Thesarit, në përputhje me kërkesat ligjore. Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të auditimit financiar Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ushtruar auditim në subjektin Bashkia Tepelenë, në bazë të programit të auditimit nr. 470/1 prot., datë 25.04.2025, për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024. Me vendimin nr. 185, datë 09.10.2025, të Kryetarit të KLSH-së, janë rekomanduar disa masa organizative për përmirësimin e gjendjes. Bashkia Tepelenë, me shkresën nr. 756/7, datë 21.10.2025, ka njoftuar se është njohur me Raportin Përfundimtar dhe rekomandimet për auditimin financiar.

Nga titullari i institucionit është nxjerrë Urdhri nr. 136, datë 29.10.2025, “Për zbatimin e detyrave të rekomanduara”, i cili i është dërguar KLSH-së me shkresën nr. 756/9, datë 29.10.2025. Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik & Menaxhimit Financiar ka hartuar Planin e Veprimit nr. 756/10, datë 06.11.2025, për zbatimin e rekomandimeve të raportit të KLSH-së. Gjithsej janë rekomanduara 16 masa, janë zbatuar të gjitha rekomandimet me strukture pergjegjse Drejtorinë e finances dhe janë reflektuar ndryshime në hartimin e pasqyrave financiare të vitit 2025. Në process janë 7 rekomandime që lidhen me:

Masa organizative për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin; Auditimin e brendshëm; Arkëtimin e detyrimeve debitore, Regjistrimin e pronave të Bashkisë pranë ASHK, Zbatimin e rekomandimeve nga auditimet e mëparshme. Aktualisht, Bashkia Tepelenë ndodhet sërish në një proces auditimi me objekt Auditim përputhshmërie, për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2025, i filluar më datë 29.10.2025 deri më 19.12.2025, me shkresën nr. 1021/2, datë 12.12.2025, është njoftuar ndryshimi i programit të auditimit si më poshtë:

Objekti i auditimit ndryshon nga Auditim përputhshmërie në Auditim përputhshmërie dhe financiar” Afati i auditimit shtyhet nga data 19.12.2025 deri më 20.04.2026.

Me përfundimin e auditimit dhe daljen e raportit përfundimtar, Këshilli do të informohet në mënyrë të detajuar.

**Kryetari i Këshillit:** Ka pyetje? Nuk ka. Hidhet në votim.

**Vota pro:** 12 Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Besnik Maca.  
**Vota kundër** nuk ka. **vota abstenim** nuk ka.

**Pika 6 e rendit të ditës:** Projektvendim: “Për detajimin e plan–buxhetit për fondet nga transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale, grantin e bazuar në performancë me burim financimi buxheti i shtetit dhe të ardhurat e veta të trashëguara nga viti 2025”.

Fjalën e merr z. Spiro Kora; Për vitin 2025 Bashkia Tepelenë ka trashëguar të ardhura të konsiderueshme, në ndryshim nga vitet e mëparshme, për këtë vit Qeveria Shqiptare ka akorduar grantin mbi bazën e performancës, ku të gjitha bashkitë kanë aplikuar mbi bazën e treguesve të tyre dhe planeve të zhvillimit social-ekonomik dhe infrastrukturor. Grupi i punës është

angazhuar në hartimin e projekteve, aplikimin dhe mbrojtjen e tyre pranë ministrive përkatëse. Si rezultat, Bashkia Tepelenë është renditur e 7-ta dhe ka përfituar një fond në shumën **12,000,000 lekë**, sipas relacionit përkatës. Për pjesën që i takon buxhetit të Bashkisë dhe që ndodhet në sistemin e Thesarit, pas analizimit të treguesve buxhetorë, propozohet miratimi i shpërndarjes së fondeve sipas tabelës bashkëlidhur. Këto vlera përfaqësojnë tavanet buxhetore dhe do t'i nënshtrohen të gjitha procedurave ligjore të prokurimit për realizimin e ndërhyrjeve të parashikuara në buxhet.

**Kryetari i Këshillit:** Ka pyetje? Nuk ka. Hidhet në votim.

**Vota pro (12):** Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Besnik Maca.  
**Vota kundër nuk ka. vota abstenim nuk ka.**

**Pika 7 e rendit të ditës:** Projektvendim: “Për përcaktimin e destinacionit/qëllimit të përdorimit të fondit nga granti i bazuar në performancë për vitin 2025, me burim financimi të huaj”.

Fjalën e merr z. Spiro, ky projektvendim është në të njëjtën linjë me pikën paraardhëse, me ndryshimin se në këtë rast fondi ka siguri të plotë financimi nga burime të huaja.

**Kryetari i Këshillit:** Ka pyetje? Nuk ka. Hidhet në votim.

**Vota pro (12):** Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Besnik Maca.  
**Vota kundër nuk ka. vota abstenim nuk ka.**

**Pika 8 e rendit të ditës:** Raporti i performancës së Këshillit Bashkiak Tepelenë për vitin 2025.

Kryetari i Këshillit; materiali është shpërndarë më parë dhe pyet nëse ka nevojë të lexohet i plotë raporti.

Fjalën e merr z. Ditar Hodaj; Falënderon Sekretaren e Këshillit Bashkiak për përgatitjen e materialit.

**Kryetari i Këshillit:** Ka pyetje? Nuk ka. Hidhet në votim;

**Vota pro (12):** Arben Gumeni, Latif Kaçaj, Miftar Meta, Ditar Hodaj, Matilda Çela, Ilir Haska, Marsela Balili, Mirela Varfi, Mjaftoni Zeraj, Vladimir Bakiaj, Vladimir Gjonca, Besnik Maca.  
**Vota kundër nuk ka. vota abstenim nuk ka.**

**Pika 9 e rendit të ditës:** Trajtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve.

Kryetari i Këshillit Bashkiak paraqet një kërkesë të bërë nga z. Imer Elezaj, banor i fshatit Lab-Martaloz, Njësia Administrative Lopës, i cili kërkon nga Bashkia Tepelenë leje për ndërtimin e një cezme në varrezat e fshatit, me shpenzimet e tij. Këshilli nuk jep leje, por duhet që kërkesa t'i

drejtohet Bashkisë. Për çdo kërkesë në fshatra, është e domosdoshme që të gjithë banorët e fshatit të jenë dakord.

Fjalën e merr z. Besnik Maca; Çezma është për komunitetin.

**Kryetari i Këshillit:** Cezma është për komunitetin, por duhet mendimi i gjithë banorëve. Këshilli miraton vetëm projektvendimet që sjell Bashkia, dhe për këtë nevojitet edhe miratimi i Kryetarit të fshatit.

Z. Latif Kaçaj; Për këtë kërkesë ka ardhur një ankese tjetër nga fshati, se ndërtimi mund të keqpërdoret për qëllime personale dhe të krijojë konflikt në komunitet, fshati nuk e pranon ndërtimin e cezmes.

**Kryetari i Këshillit:** Nëse fshati nuk e pranon, Kryetari i fshatit duhet t'i drejtohet Bashkisë për trajtimin e ankesës.

**Latif Kacaj:** Për këtë kërkesë ka ardhur një ankese tjetër nga fshati dhe kjo cezem bëhet për qëllime personale, sepse futet në konflikt fshati.

**Kryetari i Këshillit :** Në qoftë se nuk do fshati, Kryetari i fshatit t'i drejtohet Bashkisë.

**Znj. Mjaftoni Zeraj:** Unë e pashë objektin është larg nga varrezat, jashtë rrethimit të tyre. Nuk ka konflikt, sipas shkresës së Administratorit të Njësisë Lopes. Objekti është një cezmë që shërben për komunitetin, në rast se konstatohet se cezma ndërtohet për interesa individuale dhe jo për komunitetin, Këshilli ka të drejtën ta heqë atë.

**Kryetari i Këshillit:** Nuk jepen leje individuale, kërkesa duhet t'i drejtohet Bashkisë. Kërkesa individuale nuk pranohet si investim për komunitetin. Nëse bëhet investim për komunitetin, kërkesa duhet të vijë nga komuniteti.

**Kërkesë** për dhënie me qera afatgjatë me të drejtë parablerje të pronave të trashëguara, nga z. Veip Tafil Llakaj, fshati Salari – kjo kërkesë i delegohet Bashkisë, zyrës përkatëse.

**Kërkesë nga z. Fatmir Bejko,** banor i fshatit Dukaj, Njësia Administrative Qendër, për ndihmë financiare për dëmtimin e parcelës bujqësore nga reshjet e shiut – kjo kërkesë i delegohet Bashkisë, zyrës përkatëse.

**Kërkesë nga z. Sinan Islami,** banor i fshatit Dukaj, Njësia Administrative Qendër, për ndihmë financiare lidhur me dëmtimin e parcelës bujqësore nga reshjet e shiut – kjo kërkesë i delegohet Bashkisë, zyrës përkatëse, për trajtim.

**Kërkesë nga Kryesia e fshatit Luzat** (bashkëngjitur kërkesa) – kjo kërkesë i delegohet Bashkisë, zyrës përkatëse, për të dhënë përgjigje.

**Kërkesë nga z. Aristotel Meshini,** banor i fshatit Peshtan, Njësia Administrative Qendër, për ndihmë financiare për arsye shëndetësore – kjo kërkesë i delegohet Bashkisë, zyrës përkatëse.

**Kërkesë nga OSSH**, për territorin e nënstacionit, ku kërkohet marrja e pasurisë që përmbush kriteret e parashikuara në ligj për t'u administruar nga Ministria e Infrastrukturës – kjo kërkesë është bashkëngjitur dhe i delegohet Bashkisë për veprim të mëtejshëm.

**Mbyllja e mbledhjes, ora 11:50.**

**SEKRETARI KËSHILLIT**  
Valbona ÇELA

**KRYETARI KËSHILLIT**  
Arben GUMENI

